



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria—Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

**Thirrje publike për aplikim në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin
“Hannover Messe 2024” të Gjermanisë**

Data e organizimit:
22-26 prill 2024
Adresa: Messegelände
30521 Hannover

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare të sektorit të Teknologjisë Informative (TIK) dhe sektorit të Përpunimit të Metalit, në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të produkteve dhe shërbimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë këtij aktiviteti ndërkombëtarë. KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e stendës, regjistrimin e 8 subjekteve pjesëmarrëse (4 prej tyre nga sektori i TIK-ut dhe 4 prej sektorit të përpunimit të metalit), shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit dhe dërgimin e materialeve promovuese të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse. Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 29.03.2024. Dokumentet e plotësuar si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Dëshminë e xhirlogarisë aktive në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetim (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;
7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK); dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet. Për këtë aktivitetet sipas kriterëve në vijim dhe vlerësimit të pikëve do të përzgjidhen 8 subjekte:

- 4 nga sektori i TIK-ut; dhe
- 4 nga sektori i përpunimit të metalit.

Kriteret e vlerësimit:

Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:

- 1 pikë për 1 produkt
- 3 pikë për 2 produkte
- 5 pikë për 3 produkte
- 7 pikë për 4 produkte dhe
- 10 pikë për 5 e më shumë produkte.

Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:

- Gjuhë Angleze 5 pikë
- Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
- Gjuhë tjera 1 pikë.

Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:

- Gjuhë angleze 4 pikë
- Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
- Gjuhë tjera 2 pikë.

Shtetet ku janë eksportuar produktet/shërbimet e subjektit aplikues gjatë vitit 2023, maksimum 10 pikë:

- Shtetet e BE-së 5 pikë
- Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
- Shtetet tjera 2 pikë.

Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:

- ISO 27001 3 pikë dhe
- Certifikime tjera 2 pikë.

Paraqitja e subjektit aplikues në panair apo dhe B2B takime në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:

- 1 deri në 3 panair 3 pikë
- 3 deri në 6 panair 5 pikë.

Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2023, maksimumi 10 pikë:

- 0 - 500.000 euro 4 pikë
- 500,001 – 1,000,000 euro 8 pikë dhe
- > 1,000.000 euro 10 pikë.

Për kompanitë Start-up, qarkullimi i subjektit aplikues në vitin 2023, maksimumi 10 pikë:

- 0 - 50.00 euro 4 pikë
- 50.01 – 5,000 euro 8 pikë dhe
- > 5,000 euro 10 pikë;

Më 25.03.2024, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do të ju ofrojnë me shumë informacione rreth aktiviteteve ndërkombëtare si dhe do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Vlen të theksohet se në këtë panair do të marr pjesë Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, si dhe Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë znj. Rozeta Hajdari. Po ashtu, në kuadër të këtij aktiviteti parashihet që të realizohen edhe takime B2B si dhe takime me palë të interesuara për mundësitë e investimit në Kosovë.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashke me dokumentet e tjera përcjellëse në mënyrë elektronike më së largu deri më 29.03.2024 në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehjet e interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit:

mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën Export.Kiesa@rks-gov.net